

Nr. PROTOK 412

DATE 09.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 4389/Prot.

Tiranë, më 09.07.2024

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"(CIT)

Adresa: Kompleksi Xhura, Njësia Bashkiake Nr.12, Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 351, datë 09.07.24 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inteligjencë Artificiale dhe Data Science" (Artificial Intelligence and Data Science), në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"(CIT)".

Raporti i vlerësimit të ekspertëve të jashtëm është pozitiv, por është lënë sugjerim që në dokumentacionin e programit të studimit të reflektohen të dhëna për koordinatorin e programit të studimit, si dhe për lëndë specifike që kanë në syllabus elementë të tjerë të aktiviteteve formuese të pasqyrohen në syllabus në mënyrë më të detajuar tematikat e detyrave/projekteve apo tematikat e punëve laboratorike dhe javët kur zhvillohen.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4389/1 Prot.

Tiranë, më 09.07. 2024

URDHËR

NR. 351, DATË 09.07.2024

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË
“INTELIJENCË ARTIFICIALE DHE DATA SCIENCE” (ARTIFICIAL
INTELLIGENCE AND DATA SCIENCE), NË KOLEGJIN UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË” (CIT)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inteligjencë Artificiale dhe Data Science” (Artificial Intelligence and Data Science), me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 63BA0619A.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Inteligjencë Artificiale dhe Data Science” (Artificial Intelligence and Data Science), në Fakultetin e Inxhinierisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT) referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inteligjencë Artificiale dhe Data Science” (Artificial Intelligence and Data Science), në Fakultetin e Inxhinierisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës

së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT).

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

